



BASHKIA KORÇË

**RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË
FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË
BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2019**

MAJ 2020

Tabela e Përmbajtes

1. Hyrje.....	3
2. Analiza e buxhetit e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019.....	3
2.1. Analiza e detajuar e burimeve të financimit.....	4
✓ Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019.....	4
✓ Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2019.....	35
✓ Transferta e kushtëzuar 2019.....	35
✓ Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.....	38
2.2. Analiza e detajuar e shpenzimeve për vitin 2019.....	39
• Dokumentacioni bazë.....	40
• Dokumentacioni shoqërues.....	43
3. Analiza e shpenzimeve sipas programeve dhe institucioneve.....	45
3.1. Bashkia.....	45
3.2. Analiza e detajuar sipas programeve për Institucionet e Varësisë.....	114
❖ Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.....	114
❖ Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.....	124
❖ Qendra e Artit dhe Kulturës.....	140
❖ Klubi Shumësportësh.....	146
❖ Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social.....	148
❖ Shtëpia e Foshnjës.....	150
❖ Qendra Rezidenciale e Zhvillimit.....	151
❖ Qendra Ditore.....	152

1. Hyrje

Në zbatim të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, Bashkia Korçë ka përgatitur raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2019, i cili përfshin informacion të detajuar, në lidhje me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në nivel programi. Ky raport bazohet dhe në raportin vjetor dhe në raportin e monitorimit të vitit 2019 dhe është i krahasueshëm me buxhetin vjetor 2019, i miratuar me VKB nr. 152, datë 27.12.2018 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2019 të Bashkisë Korçë”.

2. Analiza e buxhetit e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019

Plani i të ardhurave dhe realizimi i tyre si më poshtë:

Tabela: Burimet e financimit

000/lekë

Nr.	Burimet e financimit	Plan 2019	Fakt 2019	% e realizimit
1	Të ardhurat e trashëguara	293,882	293,882	100%
2	Transferta e pakushtëzuar	439,016	439,016	100%
3	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	307,448	307,448	100%
4	Fondi i Zhvillimit te Rajonit (FZHR)	80,601	80,601	100%
5	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	1,038,642	650,610	63%
6	Të ardhurat e institucioneve të varësisë	34,163	15,640	46%
7	Sponsorizime të ndryshme	1,379	1,379	100%
8	Grande (grandi japonez, +transfera nga qarku, + Ballkani Perendimor)	14,247	14,103	99%
9	Projektet IPA	13,470		0%
	Total	2,222,848	1,802,678	81%

Plani i shpenzimeve dhe realizimi i tyre si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet	Plan	Fakt	% e realizimit
1	Shpenzime personeli (paga+sigurime shoqërore)	644,808	594,339	92%
2	Shpenzimet operative	668,152	478,146	72%
3	Shpenzime (principali & interesi)	56,850	53,759	95%
4	Subvencione	10,000	9,999	100%

5	Transferta tek organizata të ndryshme	149,655	78,614	53%
6	Transferta tek individët	11,493	7,964	69%
7	Hartim projektesh dhe oponenca teknike	20,270	397	2%
8	Fondi rezerve dhe fondi i kontigjences	3,000		0%
9	Shpenzime kapitale	495,872	283,243	57%
10	Shpenzime kapitale VKM	82,147	61,579	75%
11	Shpenzime kapitale FZHR	80,601	80,601	100%
	Total	2,222,848	1,648,641	74%

2.1. Analiza e detajuar e burimeve të financimit

✓ Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2019

Bashkia Korçë për vitin 2019 kishte planifikuar të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 1,038,642 mijë lekë dhe realizimi në vlerë 650,610 mijë lekë ose 63%.

Raporti vjetor i të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Korçë është një pasqyrë e veprimtarisë dhe rezultateve të administratës të Bashkisë Korçë gjatë vitit 2019 në raport me objektivat e vitit 2019.

Drejtoritë e Bashkisë Korçë janë përgjegjëse për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave. Mbledhja e të ardhurave ka pasur për synim të realizohej nëpërmjet nxitjes së përmbushjes vullnetare të pagesave për taksat dhe tarifatat lokale duke kërkuar nga të gjithë subjektet apo familjarët kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore. Gjithashtu po gjatë vitit 2019 janë ndërmarrë dhe zbatuar masat shtrënguese të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të gjitha subjektet apo familjarët që kanë rezultuar debitore për vitet paraardhëse.

Ndryshe nga çdo vit praktika jonë gjatë vitit 2019 u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me të gjitha subjektet apo familjarët që kanë detyrim të paguajnë taksa apo tarifa, duke investuar në forcimin e besimit në përmbushje të nevojave të tyre apo shërbimeve të cilat këta të fundit marrin.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 objektivat kryesore të Bashkisë Korçë kanë qenë:


- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare dhe informimi në kohë i taksapaguesve për detyrimet që këta të fundit kanë duke ju bërë të qarta dhe pasojat në rast mos përmbushje vullnetare apo moszbatim afatesh.
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave.

- Rritja e performancës së ofrimit të shërbimeve.
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit.
- Zbatimi i masave shtrënguese dhe lufta kundër informalitetit

Realizimi i të ardhurave në total për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Korçë ka rezultuar me rritje të të ardhurave krahasim ky i bërë duke marrë për bazë si vit krahasimor vitin 2019 me vitet paraardhëse të periudhës krahasimore për Bashkinë Korçë mbas reformës territoriale.

Për ilustrim dhe paraqitje grafike po japim trendin e realizimit të të ardhurave për taksa dhe tarifa vendore për periudhën 2016 – 2019:

Vitet	2016	2017	2018	2019
Të ardhurat për periudhën	542,951,991	562,091,525	620,322,397	650,610,416



Më poshtë po paraqesim tabelën e planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave për vitin 2019 si dhe realizimin për vitet 2016-2018.

Nr	EMËRTIMI	Realizim 2016	Realizim 2017	Realizim 2018	Realizim 2019	Planifikim 2019	Në %
1	TATIM FITIMI I THJESHUAR PËR BIZNESIN E VOGËL	11,870,476	6,728,100	5,190,961	5,555,848	23,000,000	24%
2	TAKSË MBI NDËRTESESËN	120,053,537	103,192,896	102,952,983	96,209,399	149,569,021	64%
3	TAKSË MBI TRUALLIN	4,709,608	6,119,732	9,127,377	8,109,107	9,000,000	90%
4	TAKSË TABELË	16,169,736	13,361,853	9,551,861	8,140,330	15,903,439	51%

5	TAKSË HOTELI	3,191,464	3,931,249	5,059,780	5,754,310	5,500,000	105%
6	TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA	64,598,635	59,139,584	59,464,396	87,219,242	240,000,000	36%
7	TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET	8,218,906	15,711,598	26,006,146	13,435,258	40,000,000	34%
8	TAKSË NDIK.INFRAST.MINISTRIA E ENERGJISË	1,804,439	11,624,815	1,958,811	0	16,000,000	0%
9	DIVIDENTI NGA U.K.KO	5,344,671	4,433,134	7,864,515	15,515,582	9,000,000	172%
10	DIVIDENTI NGA TREGU I SHUMICËS	0	1,233,662	0	0	1,600,000	0%
11	RENTA MINERARE	62,524	74,247	110,375	575,607	200,000	288%
12	TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE	22,450,806	20,816,412	22,657,362	17,871,801	48,672,040	37%
13	TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	23,195,018	24,619,201	37,623,253	41,140,294	42,000,000	98%
14	TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME	4,412,297	7,389,180	9,590,732	9,161,810	13,000,000	70%
15	TARIFË PASTRIMI	109,957,985	112,670,439	155,983,218	158,711,065	183,509,590	86%
16	TARIFË NDRIÇIMI	36,317,435	36,266,541	37,942,813	35,295,758	44,423,704	79%
17	TARIFË GJELBËRIMI	22,321,664	23,683,772	24,707,001	23,404,849	31,716,687	74%
18	TARIFË SERVITUTI	1,238,474	1,041,376	486,544	508,116	1,000,000	51%
19	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,235,530	2,562,060	1,065,480	1,605,680	2,600,000	62%
20	TARIFË PARKIMI	16,475,497	16,973,951	20,666,333	18,707,966	22,900,000	82%
21	TARIFË MUR PERIMETRAL	400,438	570,146	628,832	1,092,020	1,500,000	73%
22	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	287,000	420,000	440,000	510,000	760,000	67%
23	TARIFE PER DHËNIEN NË PËRDORIM TË TUBC. NËNTOKË	0	0	5,040	0	3,000	0
24	TARIFË PËR ZENIE HAPESIRE PUBLIKE	7,491,437	9,184,159	15,048,221	21,024,032	30,388,546	69%
25	TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA	4,145,700	3,529,420	782,100	185,000	862,500	21%
26	TARIFË UJI I PIJSHEM	2,560,664	231,521	129,372	85,020	350,000	24%
27	TARIFË VARREZA	10,597,898	12,908,387	14,273,419	12,948,926	18,834,554	69%
28	TARIFË THERJE BAGËTI	571,200	1,034,950	2,397,550	2,175,500	3,000,000	73%
29	TARIFË PËR LEJE NDËRTIMI	0	28,000	123,000	190,000	500,000	38%
30	QERA OBJEKTI + QERA TRUALLI + QERA TOKA BUJQESORE	3,668,608	1,967,308	1,908,587	5,175,093	8,625,210	60%
31	TË ARDHURA TË TJERA (vertetime,çertifikata etj.)	10,123,920	6,960,357	4,756,533	11,082,825	18,137,025	61%
32	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	583,800	2,445,800	498,400	1,517,600	500,000	304%
33	MIRATIM PROJEKTI	297,500	108,500	119,000	562,450	300,000	187%
34	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIG.	0	0	0	0	30,000	0%
35	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË BASHKI FQINJE	0	0	0	0	1,348,250	0%
36	MARRJE ME QERA PYLLI (KULLOTA+TOKE BUJQESORE)	619,450	29,405,175	13,872,624	13,941,946	13,000,000	107%
37	TË ARDH.NGA SHITJA E DRUVE	8,761,441	2,488,686	3,755,676	12,540,960	16,330,820	77%
38	VËRTETIME TRANSPORTI	0	90,000	108,000	78,000	50,000	156%
39	PRODHIME TË DYTA MEDICINALE	0	182,900	289,250	663,000	400,000	166%
40	SHITJE DOKUMENTA ANKANDI	0	1,000	1,000	4,000	2,000	200%

41	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	1,095,000	1,455,000	2,557,000	1,540,500	2,500,000	62%
42	GJOBË PËR VONESË NË PAGESË	6,293,881	5,767,647	7,466,884	6,186,821	7,000,000	88%
43	GJOBA TË DREJT. SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	656,100	536,500	341,500	340,500	660,000	52%
44	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	900,000	750,000	2,160,000	1,302,000	2,500,000	52%
45	GJOBA TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE	0	60,000	60,000	160,000	300,000	53%
46	GJOBA M.N.Z.SH	0	0	0	10,000	0	
47	TË ARDH.NGA QERATË,BANESA SOCIALE	6,895,065	6,946,843	6,929,215	7,059,294	7,080,000	100%
48	QERA NGA BANESAT NË PRON.TË BASHKISË, ENTI BANESAVE	3,177,200	3,040,643	3,243,939	2,863,855	3,585,200	80%
49	KAMAT VONESA (QIRA OBJEKTI)	196,988	404,782	417,314	449,054	500,000	90%
	TOTALI	542,951,991	562,091,525	620,322,397	650,610,416	1,038,641,586	63%

TË ARDHURA NGA TAKSAT DHE TATIMET

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël	23,000,000	5,555,848	24 %

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël në buxhetin e vitit 2019 është planifikuar 23,000,000 lekë dhe realizimi i tij deri në fund të vitit 2019 është në masën 24 % ose në vlerën 5,555,848 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve paraardhëse si taksë vendore të pa paguara nga 30 subjekte debitore në vlerën 1,014,705 lekë dhe nga arkëtimi i vlerës 4,541,143 lekë konkretisht nga 25 subjekte për vitin 2014 me vlerë 723,715 lekë, nga 33 subjekte për vitin 2015 me vlerë 539,900 lekë, nga 35 subjekte për vitin 2016 me vlerë 323,862 lekë, nga 21 subjekte për vitin 2017 në vlerën 129,741 lekë, nga 133 subjekte gjatë vitit 2018 në vlerën 2,746,019 dhe nga 19 subjekte gjatë vitit 2019 në vlerën 77,906 të cilat janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë si tatim i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agjentit tatimor.

TAKSË MBI NDËRTESEN


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
2	Taksë mbi ndërtesën	149,569,021	96,209,399	64 %

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 149,569,021 lekë dhe është realizuar në masën 64% ose në vlerë 96,209,399 lekë konkretisht nga :

- Nga 344 subjekte të biznesit të madh në vlerën 19,665,850 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 63 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 2,496,795 lekë.
- Nga 1495 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,043,534 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 180 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 1,885,271 lekë.
- Nga 5 organizata jo fitimprurëse në vlerën 36,089 lekë.
- Nga 353 pronarë ndërtesash të cilët ambientet e tyre ju a kanë lëshuar me qira subjekteve të biznesit të madh apo të vogël në vlerën 9,025,323 lekë si dhe nga 89 pronarë ndërtesash debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 2,899,779 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2019 në vlerën 30,300,444 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 7,550,090 lekë. Nga abonentët familjarë të Njërive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2019 në vlerën 6,227,491 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet 2017-2018 por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 943,773 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 por edhe detyrimet e viteve të mëparëshme në vlerën 685,374 lekë.

- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë kanë likuajduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 1,137,025 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2019 në vlerën 1,312,561 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të taksës së ndërtesës po i ilustron grafikisht :




TAKSË MBITRUALLIN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
3	Taksë mbi truallin	9,000,000	8,109,107	90 %

Taksa mbi truallin për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 90 % ose në vlerë 8,109,107 lekë. Taksa mbi truallin përfshin kategoritë e truallit për biznes dhe truallit për banim. Kjo taksë është arkëtuar në këtë nivel nga :

- Nga 156 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,455,742 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 14 subjekte të biznesit të madh debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2019 në vlerën 384,001 lekë.
- Nga 79 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 894,900 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 12 subjekte të biznesit të vogël debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2019 në vlerën 92,985 lekë.
- Nga poseduesit e truallit për banim në territorin e Bashkisë Korçë në vlerën 778,623 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 281,137 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2019 në vlerën 221,719 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të taksës mbi truallin po i ilustron grafikisht :



TAKSË TABELE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
4	Taksë tabelle	15,903,439	8,140,330	51 %

Taksa e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 15,903,439 lekë dhe është realizuar në masën 51 % ose në vlerën 8,140,330 lekë. Kjo taksë është realizuar nga :

- Nga 90 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi dhe reklamimi në vlerën 7,752,271 dhe lekë.
- Nga 54 subjekte debitorë për vitet e mëparëshme që e kryen pagesën për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi gjatë vitit 2019 në vlerën 388,059 lekë.

TAKSË E FJETJES NË HOTEL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
5	Taksa e fjetjes në hotel	5,500,000	5,754,310	105 %

Taksë fjetje në hotel për vitin 2019 është planifikuar 5,500,000lekë dhe është realizuar në masën 105 % ose në vlerën 5,754,310 lekë. Ky realizim në këtë vlerë apo dhe përqindje kundrejt planifikimit vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren. Nga kontrolli i ushtruar periodikisht gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsej 754 aktkonstatime ku janë verifikuar dhe kontrolluar regjistrat e fjetjes në lidhje me deklarin e personave të akomoduar në çdo subjekt që ushtron aktivitet “Hoteleri/Bujtinë” ose ofron shërbimin e fjetjes kundrejt pagesës në territorin e Bashkisë Korçë. Kjo taksë është arkëtuar në këtë nivel nga :

- 81 subjekte që kanë deklaruar në total një numër akomoduesish prej 67489 persona/shtretër në vlerën 4,724,230 lekë detyrime këto të vitit 2019 (pa përfshirë detyrimin e muajit dhjetor 2019 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2020 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale).

- 63 subjekte në vlerën 582,890 lekë, detyrim ky i muajit dhjetor 2018 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2019 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale.
- Nga 16 subjekte debitorë të viteve të mëparshme që e kryen pagesën gjatë vitit 2019 në vlerën 447,190 lekë.

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	240,000,000	87,219,242	36%

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 240,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 36 % ose në vlerën 87,219,242lekë.

Kjo taksë është realizuar si pasojë e dhënies së 149 lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje me destinacion banimi në vlerën 56,890,624 lekë, për 89 objekte
- Leje me destinacion banim + ekonomike në vlerën 7,797,257 lekë, për 8 objekte
- Leje me destinacion ekonomik në vlerën 22,531,361 lekë, për 52 objekte

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	40,000,000	13,435,258	34 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 40,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2019 është realizuar në masën 34 % ose në vlerën 13,435,258 lekë.

Ky realizim vjen si rezultat i legalizimit të 326 objekteve dhe kryerjes së pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndarë si më poshtë :

- Për destinacion banimi në vlerën 11,199,076 lekë, për 292 objekte
- Për destinacion banim + ekonomike në vlerën 813,445 lekë, për 17 objekte
- Për destinacion ekonomik në vlerën 1,422,737 lekë, për 17 objekte

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË (MINISTRIA E ENERGJISË)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	16,000,000	-	-

Kjo taksë është planifikuar në vlerën 16,000,000 lekë si rezultat i investimeve që Ministria e Energjisë ka kryer në rajonin e Bashkisë Korçë, por për vitin 2019 nuk pati asnjë arkëtim nga kjo e fundit për llogari të Bashkisë Korçë.

DIVIDENTI NGA U.K.KO

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
9	Dividenti nga U.K.KO	9,000,000	15,515,582	172%

Të ardhura nga Dividenti U.K.KO për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 15,515,582 lekë ose në masën 172 %. Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat i kalimit të dividendit për llogari të Bashkisë Korçë nga U.K.KO për vitin 2018 në vlerën 6,942,689 lekë dhe në vlerën 8,572,613 lekë dividend i derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga viti 2015.

DIVIDENTI NGA TREGU I SHITJES ME SHUMICË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
10	Dividenti nga tregu i shitjes me shumicë	1,600,000	0	-

Të ardhura nga dividenti i tregut të shitjes me shumicë për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 1,600,000 lekë. Edhe për vitin 2019 pavarësisht planifikimit nuk pati realizim të këtij zëri pasi dividenti i mbledhur i vitit 2018 u kalua për investime në Tregun me Shumicë të Fruta Perimeve, investime këto të cilat po përmirësojnë kushtet dhe ofrimin e shërbimit si për tregëtarët e shumicës që operojnë në të ashtu edhe për subjektet të cilat kryejnë furnizimet ditore në këtë treg.

RENTA MINERARE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
11	Renta minerare	200,000	575,607	288%

Të ardhura nga renta minerare për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 200,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 575,607 lekë ose në masën 288 %. Renta minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, nëçastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Realizimi në këtë masë vjen si rezultat i arkëtimeve të prapambetura të cilat nuk ishin kaluar për llogari të Bashkisë nga ana e DRT Korëë në masën 548,110 lekë për periudhën Dhjetor 2017 deri në Nëntor 2018.

TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
12	Taksë mbi tokën bujqësore	48,672,040	17,871,801	37%

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2019 është planifikuar 48,672,040 lekë dhe është realizuar në masën 37 % ose në vlerën 17,871,801 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga poseduesit e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë që kryen pagesën për detyrimin e vitit 2019 në vlerën 9,454,696

lekë dhe nga debitorët e viteve paraardhëse të cilët kryen pagesën gjatë vitit 2019 në vlerën 8,417,105 lekë. Taksa mbi tokën bujqësore është një nga taksat për të cilën theksojmë se nga ana jonë përveç njoftimeve, takimeve informuese në lidhje me detyrimin për pagim të kësaj takse për vitet aktuale sidomos prej vitit 2016 ku Bashkia Korçë ka punuar në lidhje me arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të cilat siç duket janë në nivel të njëjtë me atë të detyrimeve që këta posedues tokash bujqësore paguajnë gjatë vitit korent. Kjo taksë ka një mosrealizim prej 30,800,239 lekë referuar të dhënave që ne disponojmë për të ardhurat e vitit korent, por nëse ne krahasojmë realizimin e kësaj takse nga të gjitha ish komunat e mbledhura së bashku për vitet para reformës territoriale të ardhurat në total kapnin vlerën e 400,000 lekë ndërkohë që ne kemi arritur ta 4 ose 5 fishojmë këtë arkëtim falë punës së këtyre viteve, të ulim detyrimet e prapambetura, të saktësojmë sipërfaqet reale pasi i vetmi informacion që na u vu në dispozicion ishin regjistrat e ndarjes së tokës familjeve bujqësore në vitin 1991. Është një taksë që atakohet shumë dhe nga ana e taksapaguesve pasi shumica e tyre kundërshtojnë faturat të cilat kanë të përfshira dhe detyrimet debitore. Në lidhje me këtë taksë janë marë dhe vazhdojnë të meren masat shtrënguese. Gjithashtu vazhdon puna në terren si për informim, njoftim, saktësim sipërfaqesh apo dhe saktësim të dhënash mbasi gjatë gjithë periudhës 1991-2016 kishin ndryshuar shumë të dhëna nisur nga emrat e pronarëve, sipërfaqët që ishin objekt transaksionesh të ndryshme dhe për të cilat nuk ishte pasqyruar asnjë dokument pranë ish komunave.

TAKSË E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
13	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	42,000,000	41,140,294	98 %

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2019 është planifikuar 42,000,000 lekë dhe realizimi i saj për vitin 2019 është në masën 98 % ose në vlerë 41,140,294 lekë.

**TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E
PALUAJTSHME**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
14	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	13,000,000	9,161,810	70 %

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 13,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 70 % ose e shprehur në vlerë 9,161,810 lekë.

TË ARDHURA NGA TARIFAT

TARIFË E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
15	Tarifë e Pastrimit	183,509,590	158,711,065	86 %


Tarifa e pastrimit për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 183,509,590 lekë dhe është realizuar në masën 86% ose në vlerë 158,711,065 lekë. Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga 620 subjekte të biznesit të madh në vlerën 40,541,514 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 101 subjekte të Biznesit të Madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 3,598,284 lekë.
- Nga 2656 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 24,780,545 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 291 subjekte të Biznesit të Vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 1,745,558 lekë.
- Nga 117 subjekte ndërtuese që kanë paguar tarifën e pastrimit për çdo kantier ndërtimi pasi kanë tërhequr lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë, në vlerë 4,820,000 lekë detyrime këto të vitit 2019.
- Nga 87 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 2,533,000 lekë detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 22 institucione shtetërore dhe organizata jo

fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 596,927 lekë.

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2019 në vlerën 57,586,118 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 12,121,951 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësitë Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2019 në vlerën 5,392,038 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet 2017-2018 por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 1,297,530 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 362,000 lekë, nga abonentët familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 761,204 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 1,060,350 lekësi dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2019 në vlerën 1,514,045 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së pastrimit po i ilustron në grafikisht :



TARIFË NDRIÇIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
16	Tarifë Ndrëçimi	44,423,704	35,295,758	79%


Tarifa e ndrëçimit për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 44,423,704 lekë dhe është realizuar në masën 79% ose në vlerë 35,295,758 lekë. Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga 620 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,192,774 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 89 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 565,809 lekë.
- Nga 2428 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,493,458 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 282 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 652,519 lekë.
- Nga 117 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 362,000 lekë detyrime këto të vitit 2018.
- Nga 87 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 427,500 lekë detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 20 institucione shtetërore dhe organizata jo

fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 116,239 lekë.

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2019 në vlerën 10,441,340 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 2,344,207 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësitë Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2019 në vlerën 1,811,725 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet 2017-2018 por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 442,429 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 67,000 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 238,592 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 355,576 lekësi dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2019 në vlerën 784,590 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së ndriçimit po i ilustruam grafikisht :



TARIFË GJELBËRIMI


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
17	Tarifë Gjelbërimit	31,716,687	23,404,849	74 %

Tarifa e gjelbërimit për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 31,716,687 lekë dhe është realizuar në masën 74 % ose në vlerë 23,404,849 lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 592 subjekte të biznesit të madh në vlerën 3,790,543 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 86 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2019 në vlerën 334,115 lekë.
- Nga 2289 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 8,271,979 lekë, detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 233 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2019 në vlerën 452,640 lekë.
- Nga 117 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 482,000 lekë detyrime këto të vitit 2019.
- Nga 87 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 422,500 lekë detyrime këto të vitit 2019 si dhe nga 20 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2019 në vlerën 121,495 lekë.

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2019 në vlerën 7,585,950 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitore për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2019 në vlerën 1,731,553 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 47,500 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitore për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2019 në vlerën 164,574lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së gjelbërimit po i ilustruamë grafikisht :



TARIFË PËR SERUITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2018	Realizimi 2018	Përqindja
18	Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	1,000,000	508,116	51 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2019 është planifikuar 1,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 51 % ose në vlerën 508,116 lekë. Realizimi i kësaj tarifë vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- 32 subjekte që kanë paguar detyrimin për vitin 2019 në vlerën 436,286 lekë me një sipërfaqe prej 325.21 m²
- 4 subjekte debitore që kanë paguar detyrimet e viteve të mëparëshme gjatë vitit 2019 në vlerën 71,830 lekë me një sipërfaqe prej 65.5 m

TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
19	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	2,600,000	1,605,680	62%

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2019 është planifikuar 2,600,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 62 % ose në vlerë 1,1605,680 lekë. Realizimi i kësaj tarifë vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- Transport malli 144,430 lekë.
- Transport udhëtarësh me taksi 416,000 lekë.
- Transport udhëtarësh me linjë qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse 463,250 lekë.
- Autorizime kamioni të tonazhit të rëndë 582,000 lekë.

TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
20	Tarifë Parkimi	22,900,000	18,707,966	82%

Tarifë parkimi për vitin 2019 është planifikuar 22,900,000 lekë dhe deri në fund të vitit 2019 është realizuar në masën 82 % ose në vlerë 18,707,966 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- Tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet shtetërore apo subjektet private në vlerën 301,920 lekë.
- Tarifa e parkimit në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi, tarifa e parkimit të subjekteve transportit të udhëtarëve që operojnë me linja ndërqytetëse për vitin 2019 duke përfshirë këtu dhe detyrimet debitore për vitet paraardhëse në vlerën 6,478,046 lekë.
- Tarifë parkimi e arkëtuar nga subjekti i kontraktuar për vjeljen e tarifës së parkimit në qytet në vendparkimet e miratuara me pagesë në vlerën 6,951,400 lekë.
- Tarifa eparkimit me pagesë (bileta) në vlerën 4,976,600 lekë.

TARIFË MUR PERIMETRAL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
21	Tarifë mur perimetral	1,500,000	1,092,020	73%

Tarifë mur perimetral për vitin 2019 është planifikuar 1,500,000 lekë dhe është realizuar në masën 73 % ose në vlerë 1,092,020 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies së 149 lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje për destinacion banimi në vlerën 736,800 lekë, për 89 objekte
- Leje për destinacion banim+ekonomike në vlerën 41,540 lekë, për 8 objekte
- Leje për destinacion ekonomik në vlerën 313,680 lekë, për 52 objekte

TARIFË PËR LEJET E ZHVILLIMIT (TREGUESIT E NDËRTIMIT)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
22	Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit)	760,000	510,000	67 %

Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit) për vitin 2019 është planifikuar 760,000 lekë, dhe është realizuar në masën 67 % ose në vlerën 510,000 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 102 leje zhvillimi.

TARIFË PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË TUBACIONEVE NËNTOKËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
23	Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore	3,000	-	-

Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore për vitin 2019 është planifikuar 3,000 lekë

TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
24	Tarifë për zënie e hapësirave publike	30,388,546	21,024,032	69 %

Tarifë për zënie hapësire publike për vitin 2019 është planifikuar 30,388,546 lekë dhe është realizuar në masën 69 % ose në vlerën 21,024,032 lekë. Më të detajuar po e paraqesim :

- Tek inkubatori i biznesit (ish U.M.B) dhe Markata e Shijes në vlerën 7,047,125 lekë
- Hapësire publike 11,279,734 lekë
- Ekspozim malli në vlerën 783,000 lekë
- Promocione dhe panairë në vlerën 159,080 lekë
- Nga debitorët e viteve të mëparshme në vlerën 1,735,093 lekë

Ky realizim në këtë nivel vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet për zënie e hapësirave publike si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara.

TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
25	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	862,500	185,000	21 %

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2019 është parashikuar në vlerën 862,500 lekë dhe është realizuar në masën 21 % ose në vlerën 185,000 lekë. Arkëtimi i kësaj tarife gjatë vitit 2019 vjen si rezultat i masave shtrënguese që janë marrë ndaj subjekteve debitore deri në vitin 2017, pasi prej vitit 2018 subjektet të cilat operonin dhe shërbenin me tavolina në hapësira publike nuk e paguajnë më këtë tarifë, një tjetër lehtësi fiskale kjo e ndërmarë nga Bashkia Korçë në kuadër të uljes së barrës fiskale ndaj biznesit.

TARIFË UJI I PIJSHËM

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
26	Tarifë uji	350,000	85,020	24 %

Tarifa e ujit për vitin 2018 është planifikuar 350,000 lekë dhe është realizuar në masën 24 % ose në vlerën 85,020 lekë. Zbatimi i VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit një bashki një shoqëri UK ka patur parasysh përfshirjen e ujësjellësave të fshatrave në zonën e shërbimit të UKKO. Kjo ishte një risi mjaft të madhe për U.K.KO dhe Bashkinë Korçë që të ruanin apo siguronin qëndrueshmërinë financiare duke ofruar shërbime me cilësi për të gjithë konsumatorët. Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat se prej muajit qershor 2016 e në vazhdim të gjitha ujësjellësat e njësive administrative të bashkisë Korçë i kaluan për menaxhim Ndërmarjes U.K.KO apo pleqësive të fshatrave. Nga kjo periudhë vazhdojnë të arkëtohen të gjitha debitë për tarifën e ujit të akumuluar në vite në çdo njësi administrative të Bashkisë Korçë me përjashtim të Njesisë Administrative Korçë .

TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2018	Realizimi 2018	Përqindja
27	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	18,834,554	12,948,926	69 %

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike për vitin 2019 është planifikuar 18,834,554 lekë dhe është realizuar në masën 69 % ose në vlerën 12,948,926 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga:

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2019 në vlerën 7,705,482 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2019 në vlerën 1,660,921 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësi Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2019 në vlerën 1,811,725 lekë si dhe nga abonentët familjarë të Njësi Administrative të cilët ishin debitorë për vitet 2017-2018 por që kryen pagesën në vitin 2019 në vlerën 291,425 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2019 në vlerën 48,000 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2019 në vlerën 79,568 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 354,076 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse dhe kanë kryer pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2019 në vlerën 997,729 lekë.

TARIFË THERJE BAGËTIE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
28	Tarifë therje bagëtie	3,000,000	2,175,500	73%

Tarifë therreje bagëtie për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 3,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2019 është në masën 73 % ose në vlerën 2, 175,500lekë. Ky realizim ka ardhur si rezultat i therreses së 34,519 krerëve gjatë vitit 2019 nga të cilat konkretisht:

- 25,208 bagëti të imta në vlerën 1,260,400 lekë
- 2,997 gjedhë në vlerën 599,400 lekë
- 6,314 derra në vlerën 315,700 lekë

TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
29	Tarifë për leje ndërtimi	500,000	190,000	38%

Tarifë për leje ndërtimi për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 500,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2019 është në masën 38 % ose në vlerën 190,000 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 161 leje ndërtimi.

QIRA OBJEKTI, QIRA TRUALLI DHE QIRA TOKË BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
30	Qira objekti, Qira trualli, Qira T.bujqësore e.t.j	8,625,210	5,175,093	60 %

Qira objekti, qira trualli, qira tokë bujqësore e.t.j për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 8,625,210 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2019 është në masën 60 % ose në vlerën 5,175,093 lekë.

Konkretisht realizimi i këtij zëri në këtë nivel vjen si rezultat i :

- Arkëtimit të 271,051 lekë nga zëri qira trualli.
- Arkëtimit të 4,812,306 lekë nga zëri qira objekti.
- Arkëtimit të 91,736 lekë nga zëri qira tokë bujqësore.

TARIFË SHËRBIMI, VËRTETIME, ÇERTIFIKATA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
31	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata etj.	18,137,025	11,082,825	61 %

Të ardhura të tjera ku përfshihen (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, leje ushtrimi aktiviteti, tarifë regjistrim biznesi, etj), për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 12,327,000 lekë dhe është realizuar në masën 61 % ose në vlerën 11,082,825 lekë.

Këtë realizim po e detajojmë sipas zërave përbërës:

- Tarifë regjistrim biznesi në vlerën 145,000 lekë (arkëtuar nga 13 subjekte të biznesit të vogël)
- Kamatë vonesa në vlerën 229,687 lekë
- Tarifë administrative dhe rregullatore e njësisve vendore në vlerën 41,700 lekë
- Licenca apo leje për ushtrim aktiviteti në vlerën 7,000,000 lekë
- Të ardhura sekondare në vlerën 709,553 lekë
- Tarifë vendore për lëshime vërtetimi në vlerën 477,500 lekë
- Tarifë vendore për konfirmime hartash në vlerën 10,200 lekë,
- Tarifë vendore për çertifikata përdorimi në vlerën 1,699,585 lekë
- Tarifë vendore e sistemimeve të jashtme për leje ndërtimi në vlerën 5,000 lekë
- Të ardhura nga tenderat në vlerën 129,000 lekë

ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
32	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	500,000	1,517,600	304 %

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 500,000 lekë dhe është realizuar në masën 304 % ose në vlerën 1,517,600 lekë.

Konkretisht janë lëshuar 102 çertifikata për mbrojtjen nga zjarri prej të cilave 48 kanë qenë rinovim çertifikate dhe 54 çertifikata kanë qenë për herë të parë. Më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 33 çertifikata të tregut të karburanteve, pikave të GLN, autoboteve të karburantit dhe GLN.
- 21 çertifikata të bankave të nivelit të dytë.
- 6 çertifikata të subjekteve tregëtare, shërbimi dhe prodhimi
- 42 çertifikata për objekte biznesi dhe banimi

MIRATIM PROJEKTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
33	Miratim projekti	300,000	562,450	187 %

Miratim projekti për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 300,000 lekë dhe është realizuar në masën 187 % ose në vlerën 562,450 lekë. Kjo tarifë arkëtohet konkretisht nga miratimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri për çdo lejë ndërtimi. Konkretisht janë miratuar 102 projekte të cilat më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 90 projekte për banesa.
- 4 projekte për hotele
- 3 projekte për komplekse banimi
- 1 projekt për objekt poli-funksional
- 4 projekte për magazina, aktivite

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
34	Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara	30,000	0	-

Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 30,000 lekë. Gjatë vitit 2019 nuk pati asnjë rast për të ndërhyrë në objekte të siguruara si dhe nuk u arkëtuan detyrimet për ndërhyrjet e kryera në vitet e mëparshme.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË BASHKI FQINJE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
35	Shërbime zjarrfikse në bashki fqinje	1,348,250	0	-

Shërbime zjarrfikse në bashki fqinje për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 1,348,250 lekë. Gjatë vitit 2019 nuk u arkëtua asnjë detyrim nga shërbimet e zjarrfikses në bashkitë fqinje si për vitin 2019 apo dhe detyrimet e pa paguara për shërbimet e kryera në vitet e mëparshme.

MARRJE ME QIRA PYJE/KULLOTA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
36	Marrje me qira pyje/kullota	13,000,000	13,941,946	107 %

Marrje me qira pylli për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 13,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 107 % ose në vlerën 13,941,946 lekë. Kjo vlerë është arkëtuar nga:

- kontrata qiraje të lidhura me qëllim pushim, argëtim në vlerën 15,000 lekë,
- 2 kontrata qiraje të lidhura për akuakulturë në vlerën 38,200 lekë,
- 5 kontrata qiraje të lidhura me kompanitë celulare në vlerën 1,119,938 lekë,
- 7 kontrata qiraje të lidhura për ndërtim HEC-i në vlerën 2,956,534 lekë,
- 2 kontrata qiraje të lidhura për mbjellje arrorësh në vlerën 633,000 lekë,
- 2 kontrata qiraje të lidhura me TAP për shtrimin e tubacionit në vlerën 6,206,504 lekë
- 31 kontrata për kullotje në vlerën 1,163,100 lekë.
- kontrata të mbylluara në vlerën 1,809,670 lekë

TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
37	Të ardhura nga shitja e druve	16,330,820	12,540,960	77 %

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 16,330,820 lekë dhe është realizuar në masën 77 % ose në vlerën 12,540,960 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga pagesa e 2 kontratave shfrytëzimi të lidhura në vitin 2019, njëra kontratë në vlerën 795,460 lekë dhe kontrata tjetër në vlerën 11,331,000 lekë

VËRTETIME TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
38	Vërtetime transporti	50,000	78,000	156 %

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 50,000 lekë dhe është realizuar në masën 156 % ose në vlerën 78,000 lekë. Vlerë kjo e arkëtuar nga shitja e 22 blloqe vërtetime transporti për pyll Bashkiak në vlerën 66,000 lekë dhe 2 blloqe vërtetime transporti për pyll privat në vlerën 12,000 lekë.

PRODHIME TË DYTA MEDICINALE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
39	Prodhime të dyta medicinale	400,000	663,000	166 %

Të ardhura nga prodhime të dyta medicinale për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 400,000 lekë dhe është realizuar në masën 166 % ose në vlerën 663,000 lekë. Vlerë kjo e arkëtuar nga fituesi i ankandit me objekt mbledhjen, grumbullimin dhe shitjen e bimëve medicinale.

SHITJE DOKUMENTA ANKANDI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
40	Shitje dokumenta ankandi	2,000	4,000	200 %

Të ardhura nga shitje dokumenta ankandi për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 2,000 lekë është realizuar në masën 200 % ose në vlerën 4,000 lekë . Vlerë kjo e arkëtuar nga subjekti fitues i ankandit për mbledhjen, grumbullimin dhe shitjen e bimëve medicinale

GJOBË POLICIA BASHKIAKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
41	Gjobë Policia Bashkiake	2,500,000	1,540,500	62 %

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2019 është planifikuar 2,500,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2019 është në masën 62% ose në vlerën 1,540,500 lekë.

Gjatë vitit 2019 në total janë vendosur 1382 gjoba (1318 gjoba për parkim të gabuar dhe 64 gjoba për shkelje të hapësirave publike nga subjekte tregtare) në vlerën 1,476,500 lekë nga të cilat 1370 gjoba janë arkëtuar brenda vitit 2019 në vlerën 1,451,500 lekë dhe 12 gjoba për vlerën 25,000 lekë nuk mundën të arkëtohen brenda vitit 2019. Gjithashtu po brenda vitit 2019 u arkëtuan 43 gjoba në vlerën 89,000 lekë të pa arkëtuara këto nga vitet e mëparëshme dhe mbeten për tu arkëtuar dhe 41 gjoba në vlerë 67,000 lekë nga vitet e mëparëshme për të cilat po ndiqen

të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre. Gjithashtu janë parashkruar 17 gjoba me vlerë 35,000 lekë të vendosura gjatë viteve 2017-2018.

GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2019	Realizimi 2019	Përqindja
42	Gjobë për vonesë në pagesë	7,000,000	6,186,821	88 %

